



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS**

Nr. 354 Prot.

Durrës, më 08 . 09 2026

**Lënda:** Njoftim për levizje paralele.

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar.

Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionin/pozicionet:

- Pozicioni:

- 1-(nje) Instruktor i praktikës profesionale, drejtimi Hoteleri-Turizëm ( Bar–Restorant)

**1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizje paralele si vijon:

**Kritere të përgjithshme:** a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar; e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

### **Kritere të posacme për instruktor të praktikës profesionale:**

a) Të ketë të paktën nga një shkollë e mesme profesionale , pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale per të cilin/cilat po aplikon; b) të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit; d) aftësi të tjera nëse kërkohen.

### **2. Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a) letërmotivimin për pozicionin; b) jetëshkrimin (CV-në); c) kartën e identitetit; d) diplomën; e)librezën e punës; f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV ; g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h) vërtetimi të gjendjes shëndetësore; i) vërtetim të gjendjes gjyqësore; j)vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi; k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit në Shkollën e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda afatit 18.09.2026 të aplikimit të përcaktuar në shpallje.

3.Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar professional të personelit", i ndryshuar.

**DREJTORE**

**Dr. Blerina DERVISHI**

